



01/Nr. 493/2018

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 neni 11, 51.1, 52, Udhëzimi Administrativ Nr.03/2014 për Procedurën e Themelimit , Përbërjen dhe Kompetencat e Komiteteve të Përhershme në Komunë neni 4, Statuti i Komunës neni 35, 36.1, 41, Rregulloren e Punës së Kuvendit neni 45, Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit në mbledhjen e mbajtur me datë 25.01.2018 merr:

V E N D I M

PËR THEMELIMIN E KOMITETIT PËR POLITIKË DHE FINANCA TË KUVENDIT TË KOMUNËS

I

Kuvendi i Komunës miratoi vendimin për themelimin e Komitetit për Politikë dhe Financa si komitet obligativ në komunën e Hanit të Elezit.

II

Komitetit për Politikë dhe Financa përbehet prej 5 anëtarëve dhe i njëjti do të ketë këtë përbërje:

1. Qamush Brava - Kryesues i Kuvendit të Komunës
2. Nuriman Kuka -LDK
3. Nora Xhoni - AAK
4. Mehemet Ballazhi - PDK
5. Akif Shkreta -VV

III

Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës – MAPL, si dhe pas publikimit në webfaqen zyrtare të komunës.

IV

Me këtë vendim njoftohen: Kryetari i Komunës, Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, Drejtorja për Buxhet dhe Financa, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, dhe Arkivi i Komunës.

Hani i Elezit
Data:25.01.2018





Republika e Kosovës / Republic of Kosovo
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



01/Nr. 492/2018

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 neni 11, 51.1, 53, Udhëzimi Administrativ Nr.03/2014 për Procedurën e Themelimit , Përbërjen dhe Kompetencat e Komiteteve të Përhershme në Komunë neni 4, Statuti i Komunës neni 35, 36, 42, Rregulloren e Punës së Kuvendit neni 45, Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit në mbledhjen e mbajtur me datë 25.01.2018 merr:

V E N D I M
PËR THEMELIMIN E KOMITETIT PËR KOMUNITETE TË KUVENDIT TË KOMUNËS

I

Kuvendi i Komunës miratoi vendimin për themelimin e Komitetit për Komunitete si komitet obligativ në komunën e Hanit të Elezit.

II

Komitetit për Komunitete përbehet prej 5 anëtarëve dhe i njëjti do të ketë këtë përbërje:

1. Sabedin Hasallari -LDK
2. Florim Shkreta - PDK
3. Teuta Shkreta - VV
4. Hyrijete Isufi – Anëtare e Jashtme
5. Agon Dernjani –Anëtarë i Jashtëm

III

Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës – MAPL, si dhe pas publikimit në webfaqen zyrtare të komunës.

IV

Me këtë vendim njoftohen: Kryetari i Komunës, Anëtarët e Komitetit për Komunitete, Drejtorja për Buxhet dhe Financa , Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Arkivi i Komunës.

Hani i Elezit
Data: 25.01.2018

Kryesuesi i Kuvendit
MSc. Qamush Brava





Republika e Kosovës / Republic of Kosova
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



01/Nr. 491/2018

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 neni 11, 40 , 73, Udhëzimit Administrativ Nr.01/2016 për Procedurën e Themelimit, Organizimin dhe Kompetencat e Komiteteve Konsultative në Komuna neni 8, Statuti i Komunës së Hanit të Elezit neni 30, Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit në mbledhjen e mbajtur me datë 25.01.2018 merr:

V E N D I M

PËR SHPALLJEN E KONKURSIT PUBLIK PËR TRI KOMITETET KONSULTATIVE DHE ÇAKTIMIN E KRITEREVE

I

Kuvendi i Komunës miratoi vendimin për shpalljen e konkursit publik për tri Komitetet Konsultative në komunën e Hanit të Elezit dhe caktimin e kriterëve.

- Komiteti për Arsim , Kulturë Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale pesë (5) anëtarë.
- Komiteti për Zhvillim Ekonomik , Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Ambientit pesë (5) anëtarë.
- Komiteti për Shërbime Publike dhe Emergjencë pesë (5) anëtarë.

II

Kriteret:

1. Anëtarët e Komiteteve konsultative përbëhen nga qytetarët dhe përfaqësuesit e organizatave joqeveritare të cilët duhet të jenë njohës të fushave përkatëse .
2. Përfaqësimi gjinor në Komitetet Konsultative duhet të jetë sipas legjislacionit në fuqi.
3. Kandidatët për anëtar në Komitetet Konsultative duhet të jenë banor të Komunës së Hanit të Elezit.
4. Përgatitja profesionale është përparësi.

Dokumentet e kërkuara: CV, Diploma, Certifikata e lindjes, Kopje e letërnjoftimit, Certifikata e vendbanimit.

Kandidatët të cilët do të konkurrojnë do t'i nënshtrohen intervistimit.

Afati për dorëzimin e dokumenteve të kërkuara është 15 ditë nga dita e shpalljes në gazetën publike.

Dokumentet e pa kompletuara dhe ato që arrijnë pas kësaj date nuk do të shqyrtohen .

Mandati: Mandati i anëtarëve të Komiteteve Konsultative është katër (4) vjeçar. Anëtarët e Komiteteve Konsultative nuk mund të shërbejnë më shumë se dy mandate të njëpasnjëshme si anëtarë të atyre komiteteve.

Kompensimi: Për punën e tyre në Komitetet Konsultative, anëtarët e këtyre komiteteve do të kompensohen në proporcion me shumën e mëditjeve të anëtarëve të komiteteve të përhershme.

III

Kompetencat e Komiteteve Konsultative:

- Japin propozime për rregullore të ndryshme,
- Paraqesin propozime për hulumtime të ndryshme.
- Japin mendime dhe ide rreth iniciativave të ndërmarra nga Kryetari i Komunës, Komitetet e përhershme apo Kuvendi i Komunës në fushat përkatëse.
- Paraqesin pikëpamjet dhe mendimet e qytetarëve të Kryetari i Komunës dhe Kuvendi i Komunës.
- Japin propozime për zgjidhjen e problemeve të identifikuara.

IV

Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës – MAPL, si dhe pas publikimit në webfaqen zyrtare të komunës.

V

Me këtë vendim njoftohen: Kryetari i Komunës, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, dhe Arkivi i Komunës.

Hani i Elezit
Data: 25.01.2018





Republika e Kosovës / Republic of Kosova
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



01/Nr. 490 /2018

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 neni 11, 40, Udhëzimit Administrativ Nr.01/2016 për Procedurën e Themelimit, Organizimin dhe Kompetencat e Komiteteve Konsultative në Komuna neni 8 pika 3, Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit në mbledhjen e mbajtur me datë 25.01.2018 merr:

V E N D I M
PËR THEMELIMIN E PANELIT PËRZGJEDHES PËR KOMITETET KONSULTATIVE

I

Kuvendi i Komunës miratoi vendimin për panelin (ad hoc) për zgjedhës të komiteteve konsultative në komunën e Hanit të Elezit.

II

Ky panel përbëhet prej pesë (5) anëtarëve. Tre anëtarë duhet të jenë nga kuvendi i komunës, një anëtarë nga ekzekutivi i komunës dhe një anëtarë nga shoqëria civile:

1. Hanumshahe Dibrani -LDK
2. Isni Bushi-AAK
3. Teuta Shkreta-VV
4. Abil Thaçi – Ekzekutivi i Komunës
5. Nexhmedin Kalisi – Shoqëria Civile

III

Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës – MAPL, si dhe pas publikimit në webfaqen zyrtare të komunës.

IV

Me këtë vendim njoftohen: Kryetari i Komunës, Anëtarët e Panelit, Drejtoria për Buxhet dhe Financa, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, dhe Arkivi i Komunës.

Hani i Elezit
Data: 25.01.2018





Republika e Kosovës / Republic of Kosova
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



01/Nr. 528/2018

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 neni 11, 12.2 shkronja (d), 14.1 , 17 shkronja (s), Statuti i Komunës së Hanit të Elezit neni 6 shkronja (s), Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit në mbledhjen e mbajtur me datë 25.01.2018 merr:

V E N D I M
PËR CAKTIMIN E LOKACIONIT PËR VARREZA TË QYTETIT HANI I ELEZIT

I

Kuvendi i Komunës miratoi vendimin për caktimin e lokacionit për varreza të qytetit të Hanit të Elezit. Caktohet lokacioni i evidentuar në Çertifikatat mbi të drejtat e pronës së paluajtshme nr.P-73317063-00308-0 dhe P-73317063-00309-0, pronë private, kultura mal i klasit 5, vendi i quajtur “TE LAKA”, në sipërfaqe prej 15053m², zona Kadastrale Neqavc.

II

Kushtet teknike për rregullimin e varrezave i cakton Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit.

III

Zbatimin e vendimit e bëjnë Drejtoria për Shërbime Publike dhe Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit.

IV

Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës – MAPL, si dhe pas publikimit në webfaqen zyrtare të komunës.

V

Me këtë vendim njoftohen: Kryetari i Komunës, Drejtoria për Shërbime Publike, Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Arkivi i Komunës.

Hani i Elezit
Data:25.01.2018

Kryesuesi i Kuvendit
MSc. Qamush Brava





Republika e Kosovës / Republic of Kosova
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



01/Nr. 518/2018

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale neni Nr. 03/L-040 nenit 11, 12, 40, Rregulloren e Punës së Kuvendit të Komunës neni 15 shkronja (c), Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 25.01.2018 merr:

V E N D I M
PËR MIRATIMIN E PLANIT TË PUNËS SË KRYETARIT TË KOMUNËS
PËR VITIN 2018

I

Kuvendi i Komunës miratoi vendimin për planin e punës së Kryetarit të Komunës për vitin 2018.

II

Plani i punës së kryetarit të komunës për vitin 2018 përmban aktivitete dhe objektivat e punës së ekzekutivit të komunës në bazë të ligjeve të aplikueshme dhe Statutit të Komunës.

III

Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës –MAPL-së dhe pas publikimit në faqen zyrtare të komunës.

IV

Me këtë vendim njoftohen: Kryetari i Komunës, Drejtoria për Administratë, Drejtoria për Buxhet dhe Financa, Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit, Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencë, Drejtoria për Arsime, Kulturë, Rini dhe Sport, Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, Drejtoria për Zhvillimit Ekonomik, Drejtoria për Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Arkivi i Komunës.

Hani i Elezit
Data:25.01.2018





01/Nr. 515 /2018

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 neni 11 , 40, 12.2 shkronja (d), Ligjin për Financat e Pushtetit Lokal numër Nr.03/L-049 neni 2 , Rregullore për Kushtet , Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve 01/Nr.11159/2016, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 25.01.2018 merr:

V E N D I M

PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE PËR BURSA PËR STUDENTËT E KOMUNËS SË HANIT TË ELEZIT

I

Kuvendi i komunës miratoi vendimin për ndarjen e mjeteve financiare për studentët e Komunës së Hanit të Elezit për vitin akademik 2017/2018.

II

Duke ju referuar Nenit -I- të këtij vendimi mjetet të cilat do të dedikohen për ndarjen e bursave për studentë merren nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere vlera e të cilave është prej 10,000.00 €, që do të përfitojnë 20 (njëzet) studentë për dhjetë muaj nga 50.00 € në muaj.

III

Prioritetet për kuarda deficitare janë në lëminë:

Fakulteti i Mjekësisë (Mjekësi e Përgjithshme, Fizioterapi, Stomatologji).

Fakulteti i Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës (Ndërtimtari dhe i Arkitekturës).

Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike (Inxhinieri Kompjuterike, Telekomunikacion, Elektronikë, Automatikë, Sistemet Elektroenergjetike, Elektroenergjetikë Industriale).

Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike (Prodhimtari dhe Automatizim, Termoenergjetikë dhe termoteknikë, Konstruksiione dhe mekanizim, Komunikacion).

Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë (Agroekonomi, Bioteknologji në Zootekni, Lavërtari – Perimtari, Mbrojte e Bimëve, Pemëtari – Vreshtari, Veterinari).

Fakulteti i Xehetarisë dhe Metalurgjisë (Xehetarisë, Gjeologjisë, Materiale dhe Metalurgji, Teknologjisë),

Fakulteti i Shkencave Matematikë – Natyrore (Matematikë dhe Fizikë), në rast të mos plotësimit të bursave sipas kuadrit deficitare, plotësohet sipas rregullores për ndarjen e bursave.

Akademia e Arteve – (Aktrimi)

IV

Drejtimet e lartshënuara në pikën III të ju shtohen edhe 5 (pesë) pikë.

V

Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës – MAPL-së dhe pas publikimit në faqen zyrtare të komunës.

VI

Me këtë vendim njoftohen: Kryetari i Komunës, Drejtorja për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport, Drejtorja për Buxhet dhe Financa, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, dhe Arkivi i Komunës.

Hani i Elezit
Data: 25.01.2018





Republika e Kosovës / Republic of Kosovo
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



01/Nr.517/2018

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040, neni 11, 40, Rregulloren për Organizimin dhe Bashkëpunimin e Komunës me Fshatrat, Vendbanimet dhe Lagjet Urbane në Territorin e Komunës së Hanit të Elezit me numër 01/Nr.4486/2012, Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit në mbledhjen e mbajtur me datë 25. 01. 2018 merr:

V E N D I M

PËR MIRATIMIN E PLANIT TË PUNËS SË KËSHILLAVE TË FSHATRAVE TË KOMUNËS SË HANIT TË ELEZIT PËR VITIN 2018

I

Kuvendi i Komunës miratoi vendimin për planin e punës së këshillave të fshatrave të komunës së Hanit të Elezit për vitin 2018.

II

Pjesë përbërëse e këtij vendimi është plani i punës së këshillave të fshatrave të komunës së Hanit të Elezit për vitin 2018.

III

Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës –MAPL-së dhe pas publikimit në faqen zyrtare të komunës.

IV

Me këtë vendimi njoftohen: Kryetari i Komunës, Drejtorja e Administratës, Këshilli i Fshatrave të Komunës së Hanit të Elezit, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Arkivi i Komunës.

Hani i Elezit
Data: 25.01.2018

Kryesuesi i Kuvendit
MSc. Qamush Brava

